

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Hanefi Jashari, me zyrtaren ligjore Qëndresa Alimehaj, në çështjen penale kundër të pandehurit B.V.nga fsh. M., Komuna L., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, sipas akuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.7943/13 të dt. 24.06.2014, të cilën e përfaqëson Prokurori i shtetit Fatmire Cacaj, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datë 13.06.2018, në prezencën e Prokurorit të shtetit dhe të pandehurit, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli aktgjykimin, data e përpilimit të aktgjyimit 21.06.2018.

A K T G J Y K I M

I pandehuri **B.V.**, nga i ati F. dhe nëna Sh., e gjinisë B., i lindur me datë ..., në fsh. M., Komuna L., ku edhe banon, me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i ... fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i padënuar, nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse: me datë 11.11.2013, rreth orës 17:00 i pandehuri B.V., derisa ishte duke lëvizur veturën e tipit “SEAT Alhamabra”, targa regjistrimi ..., ngjyrë e gjelbërt metalike, në rrugën magjistrale Prishtinë-Ferizaj, me dy shirita qarkullimi në një drejtim, me të arritur në Ll., përballë “A.I.” nga pakujdesia ka rrezikuar jetën e njerëzve dhe të pasurisë në atë mënyrë që, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të neneve 42.1, 54.1, dhe 126.1 të LSKRR-së, ashtu që ka lëvizur me shpejtësi më të madhe se shpejtësia e lejuar në këtë pjesë të rrugës, nuk ka mbajtur distancën e mjaftueshme të sigurisë në komunikacion dhe pa u siguruar mirë se, mund të marrë një veprim të tillë pa i rrezikuar pjesmarrësit tjerë në komunikacion ndërmerr veprimin e kalimit nga shiriti i majtë në shiritin e djathtë me ç’rast, me pjesën e përparme në pjesën e pasme e godet automjetin “Renault Megane” me targa regjistrimi ..., ngjyrë e kuqe, të pronarit N.Z., tani i dëmtuar, i cili ishte i ndalur në rrugë në shiritin e djathtë, ku nga inercioni i kësaj goditje i njëjti automjet bartet përpara dhe me pjesën e parë të anës së majtë në pjesën anësore të anës së djathtë e godet auomjetin “N.P.” me targa regjistrimi ..., ngjyrë e kaltër, të dëmtuarit Z.A., i cili po ashtu, ishe i ndalur në shiritin e majtë, dhe si pasojë shkaktohen dëme materiale në automjete dhe lëndime të lehta për B. dhe I.V., E., B.S. dhe N.S., ndërkaq, A.S., pëson lëndime të rënda trupore me pasoja të përkohshme në shëndet,-

-me këtë ka kryer veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 4, 41, 49, 50, 51, 52 dhe 73 të KPRK-së, si dhe në bazë të nenit 365 KPPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

DËNIM ME KUSHT

Të akuzuarit **B.V.** i vërteton dënim me burg në kohëzgjatje prej **(8) tetë muaj**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftëse i akuzuari në afat prej **(2) dy vite**, nuk kryen vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari që ti paguaj të gjitha shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të ekspertizës së komunikacionit shumë në lartësi prej 40.88 euro, në emër të ekspertizës mjeko ligjore shumë prej 50.00 €, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20.00 (njëzet) €, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të dëmtuarit: **N.Z.**, nga P., lagjia ... V., dhe **Z.A.** nga F., rr. "M.Xh.", nr. ..., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm me aktakuzën PP/II.nr.7943/13 të dt. 24.06.2014, ka akuzuar të pandehurin B.V. nga fsh. M., Komuna L., për shkak të veprës penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar shqyrtimin fillestar me dt. 13.06.2018 dhe në këtë seancë i pandehuri është njoftuar me të drejtat e tij në këtë çështje penale dhe i është lexuar akuza ku i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar akuzën dhe nuk ka nevojë për ndonjë sqarim.

I pandehuri B.V., në fillim të shqyrtimit fillestar, ka deklaruar se e pranon fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës.

Pas pranimi të fajësisë gjykata ia ka tërhequr vërejtjen të pandehurit lidhur me pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë dënimin e kësaj vepre penale që e parasheh ligji për veprën penale Rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, dënim me e burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet, si dhe nuk do mund ti kundërshtoj provat apo të parashtrij prova në këtë çështje penale, se nuk do mund ta atakoj vendimin e gjykatës lidhur me vërtetimin jo të plotë apo të gabuar të gjendjes faktike, por se mund ta atakoj për shkak të lartësisë mbi dënimin dhe se deklarimin mbi pranimin e fajësisë gjykata detyrimisht duhet ta vlerësoj si rrethanë lehtësuese.

Prokurori i shtetit lidhur me deklarimin e pranimi të fajësisë nga ana e të pandehurit jep mendimin se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe është në përputhje me nenin 248 të KPPRK-së, i propozoj gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënoj sipas KPRK-së, pas vlerësimit të gjitha rrethanave lehtësuese dhe rënduese të cilat do ti gjen gjatë vlerësimit të dispozitave ligjore sipas KPPK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues bindet se i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e fajësisë, pranimi i fajësisë bëhet vullnetarisht nga i pandehuri, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit.

Gjykata pranimit e fajësisë nga i pandehuri e ka pranuar duke u bindur se i njëjti i ka kuptuar pasojat e pranimit të fajësisë, kurse ky pranim i fajësisë është mbështetur edhe në provat tjera të cilat gjenden në shkresat e lëndës e që vërtetojnë në mënyrë bindëse për gjykatën elementet inkriminuese të veprës penale e ku krijohet figura në tërësi e kësaj vepre penale të cilën e ka kryer i pandehuri, andaj gjykata mbi këtë bazë ka vlerësuar këto prova dhe deklarimin e pranimit të fajësisë nga i pandehuri e ka vlerësuar dhe e ka pranuar.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit gjykata i vlerësoj të gjitha rrethanat të cilat komfor nenit 73 të KPRK-ës ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, ashtu që si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin gjeti se e ka pranuar fajësinë, sinjeritetin e treguar gjatë shqyrtimit fillestar, ndërsa rrethana posaqërisht rëndësuese nuk gjeti, andaj gjykata të akuzuarin e gjykoj si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata çmon se dënimi i shqiptuar është i drejtë dhe i ligjshëm, se është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të pandehurit dhe me intesitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur. Duke gjetur se ky dënim është dënim adekuat me shkallën e rrezikshmërisë së veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit dhe se me këtë dënim ndaj tij do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë nga neni 41 të KPRK-ës.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 450 par. 2 të KPPK.

Vendimin për kërkesën pasurore juridike gjykata e ka marrë në bazë të nenit 463 par. 2 të KPPK-së.

Në bazë të dhënave të shënuara më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal,
P.nr.1931/2014, dt. 21.06.2018

Zyrtarja Ligjore
Qëndresa Alimehaj

Gjyqtari i vetëm gjykues
Hanefi Jashari

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga momenti i marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme.